Gjinia	Numri i të punësuarve	%
Burra	557	48.69
Gra	587	51.31
Totali	1144	100.00

Niveli i pagave		%
Gjinia	shuma e mjeteve	
Burra	4970786	50.28
Gra	4916338	49.72
Totali	9887124	100.00



*[Signature]*



## KOMUNA E VITISË

### INDIKATORËT E PERFORMANCËS SË PROGRAMIT BUXHETOR

#### OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

KASH është një verzion i zgjëruar i KAB ku ka për qëllim pregaditjen e buxhetit për tri vitet e ardhshme 2025-2027 përkufizon caqet e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme dhe vën kontekstin e vendosjes së shpenzimeve në sektor të caktuar.

Me komizën afatmesme buxhetore për tri vitet fiskale 2025 – 2027 të Komunës së Vitisë synohen të arrihen këto objektiva:

- ❖ Parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore
- ❖ Strategjia zhvillimore e Komunës .
- ❖ Zhvilloj, promovoj dhe rigjeneroj infrastrukturën lokale;
- ❖ Përmirësoj ambientin për të jetuar;
- ❖ Përmirësoj sigurinë dhe shëndetin e komunitetit;
- ❖ Parashikimi sa ma i detajuar dhe sa ma i sakt i të gjitha të hyrave në tërsi nga të gjitha burimet (granti qeveritar, te hyrat vetanake komunale , donacionet- të perpilohet nje buxhet i qendrushem komunal ).
- ❖ Të përcaktoj caqet agregate të të gjitha shpenzimeve në të gjitha Drejtorit sipas kategorive ekonomike.
- ❖ Zhvilloj sferën e shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit;
- ❖ Ofroj mjete për nevojtarët dhe të dëmtuarit;
- ❖ Përkrah dhe zhvilloj biznesin dhe aftësitë individuale të talenteve etj.
- ❖ Vlerësimet e përkrahjes së donatorëve të brendshëm, donatorëve të jashtëm ndërkombëtarë, agjencionet qeveritare financiare .
- ❖ Te sigurohet nje planifikim real i shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore
- ❖ Te shtohet transparencja në planifikimin e buxhetit

#### STRATEGJIA ZHVILLIMORE PËR SEKTORËT KOMUNAL

Në aspektin e strategjisë zhvillimore Komuna e Vitisë është duke e përpiluar Planin zhvillimor Komunal dhe Urban ku janë paraparë strategjit zhvillimore sektoriale në teritorin e Komunës së Vitisë në harmoni me planet Zhvillimore të Komunave fqinje . Kështu që duhet të inkorporohen prioritetet komunale me prioritetet qeveritare dhe nga kjo del se në Kornizën Afatmesme të Buxheti Komunal(KABK) duhet të kenë prioritet projektet që janë në përputhje me prioritetet e qeveris dhe komunave fqinje .

Ne duhet të prezentojmë dhe do të diskutojmë gjatë periudhës së diskutimeve publike prioritet që pretendojmë ti arrijmë me zhvillimin e buxhetit e që janë në përputhje me strategjin zhvillimore të Komunës së Vitisë.

Keto priorite sektoriale janë:

1. Infrastruktura dhe ekonomia,
2. Arsimi,
3. Shëndetsia,
4. Shërbimet Publike

#### Infrastruktura dhe ekonomia

Në sektorin e infrastrukturës nevojat janë më të mëdha për financimin e projekteve edhe pse është arritur të investohet deri më tani si prioritet i lartë mbetet ende ky sektor, dhe si objektivi në këtë sektor mbetet kompletimi i infrastrukturës komunale dhe zhvillimit ekonomik, pasi që dihet se në ekonomi ka vështësi të konsiderueshme për përkrahje direkte kështu që mbetet në fushat e politikave fiskale të bëhen përpjekjet për mbështetje të zhvillimit dhe në mënyrë indirekte përmes zhvillimit të infrastrukturës.

## **Arsimi**

Në fushën e arsimit mbetet të ofrohet infrastrukturë në rrjetin e shkollave, kabineteve profesionale dhe ngritjen e personelit arsimor për implementimin e reformave në arsim dhe zhvillimin e sistemit të arsimit

Me skemën e re të buxhetit komunal 2025-2027 parashifet që të përdoren kriteret e reja të bankës botrore për financimin e shkollave .

Programi i Arsimit dhe shkencës me plan buxhetin e vitit 2025 është ndarë në nënprograme si :

1. Administratë,

2. Arsimi parashkollor dhe qerdhjet
3. Arsimi Fillor
4. Arsimi i mesëm
- 5.

Mbetet të jepet një përshkrim më i detajuar në deklaratat e misionit në programin e arsimit .

## **Shëndetsi dhe Mirëqenie Sociale**

Situata aktuale në shëndetsi deri diku është në nivel por duhet të punohet ende në rritjen e kapaciteteve infrastrukturore për implementimin e konceptit të mjekësis familjare, mbetet edhe më tej prioritet krijimi i kushteve për implementimin e këtij koncepti. Në fushën e mirqenjes sociale komuna ka ndihmuar me mundësit e veta buxhetore nga të hyrat vetanake edhe pse këto politika sociale janë në kompetenca dhe menaxhohen nga qeveria.

Programi i Arsimit dhe shkencës me plan buxhetin e vitit 2025 është ndarë në nënprograme si :

1. Administratë,
2. Shërbimet e kujdesit primar shëndetsor ,
3. Inspekcioni shëndetsor, veterinar dhe sanitar,
4. Shërbimet sociale ( Qendra për punë sociale )

Mbetet si prioritet rishikimi i politikave të shëndetit primar nga ana e DSHSHS , rishikimi i kategorive ekonomike dhe implementimi i këtyre prioritetëve.

## **Shërbimet Publike**

Në fushën e shërbimeve publike janë bërë investime mjaft të mëdha, por mbetet të zhvillohet menaxhimi dhe definimi i përgjegjësisve me politikën dhe programet zhvillimore në lëminë e shërbimeve publike siq janë:

- Infrastruktura rrugore,
- Transporti, Energjia,
- Posta dhe telekom,
- Uji i pijes,
- Kanalizimi,
- Mbeturinat,
- Tregjet,
- Ndriqimi publik,
- Varrezat etj.

Objektiva kryesore e jona është ngritja e kualitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Buxheti i konsoliduar i Kosovës është burimi kryesor por edhe presim nga mjetet e ndara nga konferenca e donatorëve në të cilin ne i mbështesim parashikimet për investime sipas prioritetëve në projektet dhe programet tona për periudhën afatmesme 2025-2027 por me angazhimet e qytetarëve për të participuar në bashkëfinancimin e projekteve do të jetë një ndër objektivat e qëndrueshme për financimin-realizimin e projekteve me prioritet për qytetarët e komunës së Vitis .

## **Strategjia zhvillimore për sektorët komunal**

*araqitja e Planifikimit të Buxhetit Komunal nga ana e udhëheqësve të programeve buxhetore*

## **Deklarata e Misionit**

Hartimi i politikave konform ligjeve të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës dhe vendimeve të Kuvendit Komunal të Vitis për përmirësimin e politikave arsimore , shendetesore ,zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të kushteve jetësore dhe shërbimeve të të gjithë qytetarëve të Vitis.

### Historiku i shkurtër i komunës

Komuna e Vitisë shtrihet në pjesën Jugore të Kosovës, me një sipërfaqe prej 297m<sup>2</sup>, me 39 vendbanime, rreth 70,000,banorë, struktura nacionale është 98%shqiptarë , 1% serb dhe 1% të tjerë (kroat, hashkali, boshnjak ).Kjo komunë shtrihet në pjesën e Anamoravës , është teren kryesishtë i rrafshhtë , pjesërisht kodrionoro-malor, rreth vargmaleve të Kopilaqës, në kufi me Maqedonin.

Në këtë Komunë mbizotron klima e mesme kontinentale, temperaturura mesatare vjetore e ajrit është nga 10 deri në 11C, temperatura maksimale është në në gushtë deri 37.2 C dhe minimale në janar -29C.Të reshurat më të mëdha janë në maj dhe nëntor, kurse të reshurat më të vogla janë në mars dhe shator.

Komuna e Vitisë ka Lumin e Moravës së Binçës që përshkon afërsisht përmes Komunës duke i mbledhur lumenjtë e vegjel siç janë: Jezavën e Pozheranit, Kanalin që mbledh ujrat e Gëlbushit të Sllatinës , Përroit të Smirës dhe Lumit të Gërinqarit.

Vlenë të theksohet se kjo Komunë është një ndër Komunitat më të pa zhvilluara , popullsia e kësaj ane kryesisht merret me bujqësi. Ka rreth 3,100 hektar toke të punueshme , ekzistojnë rreth 1250 biznese , ka rreth 10,292 hektar pyje etj.

Ne pajtim me Statutin e Komunës, Komuna brenda territorit të vet ofron këto kushte , shërbime qytetarëve të saj:

### Shënimet Komunale:

- Ofrimin e e shërbimeve të gjithë qytetarëve ,
- Bënë planifikimin urban dhe zhvillimor,
- Kujdeset për shëndetin primar të popullsis,
- Lëshon leje për ndërtim dhe zhvillim,
- Ofron kushte per shkollimin parafillor, fillor dhe të mesëm,
- Kujdeset për shërbime sociale dhe strehim aq sa i lejojnë rregulloret dhe ligjet në fuqi,
- Kujdeset për mbrojtje të ambientit në nivelin Lokal,
- Udhëheqë me pronën e komunës,
- Ofron shërbime publike lokale dhe infrastrukturë duke perfshirë furnizimin me ujë, ujesjellsin, përpunimin e ujërave te zeza, rrugët lokale, transportin lokal, dhe planet për ngrohtore lokale,
- Shërbimet publike duke perfshire , shërbimin e zjarrfikësve dhe të emergjencës,
- Emërimin , riemërimin e shësheve ,rrugëve dhe vendeve tjera publike
- Bënë mirëmbajtjen e rrugëve , parqeve publike , hapësirave të hapura, varrezave të qytetit,
- Lëshon leje për shërbime dhe paisje duke përfshire: argëtimin, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin lokal publik dhe shërbime të taxive, gjuetin , peshkimit, restorantet dhe hotelet etj,
- Mbrojtja e konsumatoreve dhe shendetit publik,
- Kujdeset për zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe kontrollimin e ndërtimit duke u bazuar në standardet e ndërtimit,
- Etj ,

## **PROGRAMET E KOMUNËS**

### **Programi : Zyra e Kryetarit**

#### **Deklarata e Misionit:**

Përgadit të gjitha materialet e nevojshme , informacionet që kanë të bëjnë me mbledhjet e Kuvendit Kuvendit Komunal , sfera e legjislacionit të nivelit të qeverisjes lokale ( Rregulloret, Vendimeve , Udhezimeve), që kanë të bëjnë me një qeverisje më të mirë të gjitha Programeve , gjithnjë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Komunës së Vitis.

Aktivitetet e komisioneve të KK me subjektet relevante në nivelin me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira ndaj qytetarëve dhe një zhvillim ekonomik sa më të qëndrueshëm te Komunës në përgjithësi, ngritjes së mireqenjes për të gjithë qytetarët e Komunës. Ka gjithësejt 37 punëtorë.

Siguron menaxhimin ekzekutiv të Komunës, kordinon punën e programeve dhe zyrave , raporton para këshilltarëve të Kuvendit komunal si dhe kryen punë dhe detyra tjera në bazë të statutit të Komunës.

- Mban mbledhjet e rregullta me bordin e drejtorëve,
- Takimet e mengjesit,
- Takimet me pale(qytetar),
- Mbledhjet e Asamblese,
- Mbledhjet e Komitetit per Politik dhe Financa,
- Mbledhjet me Komitet tjera Komunale,
- Takimet me Institucione tjera (ministrit, ndermarrjet publike,PK, KFOR, OJQ, donator)
- Vendime të marrura,
- Përfundime të marrura,
- Takime, tryeza të rumbulakëta, konferenca me OJQ-të, shoqata të grave, trajnime etj etj .

#### **Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025**

<i>Paga dhe meditje</i>	<i>372,600.00 €</i>
<i>Mallra dhe Sherbime</i>	<i>145,000.00 €</i>
<i>Subvencione dhe transfere</i>	<i>170,000.00 €</i>
<i>Gjithes.</i>	<i>687,600.00 €</i>

### **Programi : Zyra e Kuvendit Komunal**

#### **Deklarata e Misionit:**

Përgadit të gjitha materialet e nevojshme , informacionet që kanë të bëjnë me mbledhjet e KPF-së , Kuvendit Komunal .


- Mbledhjet e AsambleseKomunale,
- Mbledhjet e Komitetit per Politik dhe Financa,
- Mbledhjet me Komitetet tjera Komunale,
- Vendime të marrura,

Takime, tryeza te rumbulaketa, etj .

#### **Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025**

<i>Paga dhe meditje</i>	<i>215,374.00 €</i>
<i>Mallra dhe Sherbime</i>	<i>17.000.00 €</i>
<i>Gjithes.</i>	<i>232,374.00 €</i>

**Programi : Administratë dhe personel**



**Administrata dhe personeli**

**DEKLARATA E MISIONIT:**

Organizon punën dhe avancoon koordinimin horizontal të të gjitha drejtorive, sektorëve dhe të gjitha formave të organizimit në administratën komunale.

Garanton dhe siguron funksionim normal dhe efikas të administratës komunale në përputhje me legjislacionin, politikën dhe vendimet e Komunitetit të Vitisë. Përgjigjet për shërbimet mbështetëse për Komunitetin si dhe për shërbimin e personelit dhe trajnimit të tij.

**Sektori i Gjendjes Civile**

**DEKLARATA E MISIONIT:**

Organizon punën për një shërbim sa më të efektshëm dhe korrekt ndaj qytetarëve që kanë nevojë për shërbimet e zyreve të gjendjes civile. Të realizojë aktin e martesës midis qytetarëve duke rrespektuar ligjëshmërinë, të verifikoj të gjitha aktet e regjistruara të lindjes dhe vdekjes, të ndjek të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me gjykatat për korrigjimet e lindjes, moshës dhe gjeneraliteteve tjera si dhe të kryej verifikime që kërkohen nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në vendin tonë. Të ofrojë shërbime të modernizuara për qytetar.

**Sektori i Protokoll-Arkivës**

**DEKLARATA E MISIONIT:**

Të zbatojë ligjet dhe aktet tjera nënligjore për punëtorët e shërbimit civil, të mbajë dhe ruajë dokumentacionin e personelit, të pasurojë dosjet e personelit, të regjistroj korrespondencën dhe të shpërndajë, të evidentojë, ruajë dhe të protokolojë të gjitha vendimet dhe aktet tjera që hynë dhe dalin nga Komuna. Të bëjë njësimin e dokumenteve me origjinalin dhe të përpunojë dosjet duke larguar ato që u ka kaluar afati i ruajtjes.

**Sektori i Komunikimit dhe Administrimit**

**DEKLARATA E MISIONIT:**

Përgjigjet për Administrimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të punës në komunë, mirëmbajtjen e mjediseve shkollore (objekteve shkollore), paisjeve teknike dhe autoveturave që janë në shërbim të institucioneve komunale. Përgatitë kërkesat për furnizime lidhur me mirëmbajtjen e objekteve dhe paisjeve, siguron automjetet e komunës dhe përcjell menagjimin dhe përdorimin e tyre. Kontrollon magazinën dhe punën e rojeve të komunës.

**Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025**

Paga dhe meditje 211,563.00 €  
Mallra dhe Shërbime 95,000.00 €

**Gjithësejtë :** 306,563.00 €


Programi : Inspektimet

Drejtoria e inspeksionit ka të punësuar 8 punëtorë në kta sektor , inspektor i pronës, tregut, ndërtimit dhe ambientit

*Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025*

Paga dhe meditje	74,326.00 €
Mallra dhe Sherbime	110,000.00 €
<b>Gjithësejtë :</b>	<b>144,326.00 €</b>

Programi : Buxhet e financa (Drejtoria për financa, ekonomi dhe zhvillim)



**DEKLARATA E MISIONIT:**

Drejtoria per buxhet dhe financa

Bënë menaxhimin e buxhetit, duke filluar nga planifikimi i buxhetit për vitin paraprak, rregullon rrjedhën e paras për të gjitha njësit buxhetore , harton pasqyrat financiare në baza tre mujore dhe përfundimtare , rregullon transferet dhe ridestinimet e mjeteve nëpër programe , i përcjell të hyrat vetanake dhe i regjistron , i pregadit për alokin duke u bazuar në planin e rrjedhës së paras , i siguron drejtoritë me shërbimet e financave dhe menaxhimin e shpenzimeve etj

**Sektor i buxhetit**

**DEKLARATA E MISIONIT:**

Bënë menaxhimin e buxhetit, duke filluar nga planifikimi i buxhetit për vitin paraprak dhe harton Buxhetin sipas udhëzimeve të MEF-it , rregullon rrjedhën e paras për të gjitha njësit buxhetore , harton pasqyrat financiare në baza tre mujore dhe përfundimtare , rregullon transferet dhe ridestinimet e mjeteve nëpër programe paraqet raporte para KPF dhe KK- të Vitisë

**Sektor i financave**

**DEKLARATA E MISIONIT:**

Sektor i financave është një nga sektoret që e perbejn drejtorin e financae ekonomis dhe zhvillimit dhe fushëveprimi i këti sektori është : mbajtja e evidences analitike i shpenzimeve për të gjitha programet Buxhetore, arhivimi dokumentacionit origjinal të ekzekutimeve të lëndëve .

**Sektor i tatimit ne pronë**

**DEKLARATA E MISIONIT:**



Menaxhon ekskluzivisht vetëm tatimin në prone; përgatitjen e faturave. Distribuimin e faturave tatimore, inkasimin e tatimit në prone, dhe raportimin e rregulltë pranë MFE.

## Sektori i Zhvillimit

### DEKLARATA E MISIONIT:

I përcjell punët e projekteve kapitale, llogarit paramasat dhe paralogarit e projekteve kapitale, i fut të dhënat në sistem për çdo projekt, i mbikçyr dhe i përcjell në periudha projektet investive dhe harton zhvillimin strategjik ,prioritetin e politikave zhvillimore për Komunën e Vitisë.

### *Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025*

Paga dhe meditje	195,000.00 €
Mallra dhe Sherbime	70,000.00 €
Shpenzime kapitale	3,539,205,00 €

**Gjithes.** 3,715,579.00 €

### Programi : Kadastrit,pronës dhe Gjeodezisë

**Deklarata e Misionit:**Zbatimi i Ligjit Ligji mbi themelimin e Regjistrimit mbi të drejtat e pronës së palujshme dhe udhëzimet administrative që rregullojnë punën e kadastrit dhe Gjeodezisë.


**Deklarata e Vizionit :**Ngritja dhe efikasiteti i Zyreve kadastrale dhe të Gjeodezisë në nivelin e Bashkimit Evropian.

**Deklarata e Qëllimit :**Ofrimi i shërbimeve Kadastrale dhe Gjeodezike qytetarëve dhe Subjekteve juridike në komunën e Vitisë.

### *Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025*

Paga dhe meditje	60,900.00 €
Mallra dhe Sherbime	10,000.00 €
Gjithes.	70,900.00 €

Programi : Arsim dhe shkencë



**DKA**

**DEKLARATA E MISIONIT:** DKA ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj në bazë të ligjit lidhur me organizimin e arsimit për fëmijët dhe të rriturit. Nxitë barazinë në mundësinë për të ndjekur arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë, në zhvillimin dhe aftësimin e personelit si dhe në të gjitha aspektet e tjera të arsimit. Respekton dhe nxitë të drejtën e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, të sanksionuara në kapitullin 4 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme. Nxitë bashkëpunimin midis mësuesve, prindërve, nxënësve dhe midis institucioneve arsimore dhe familjes. Bënë regjistrimin e të dhënave personale të nxënësve në një format të miratuar nga MASHT. Bashkëpunon ngushtë me Zyrën Rajonale të Arsimit për çështje të ndryshme të arsimit në komunë që kërkohet bashkëveprim dhe përgjigje e të dy palëve

**Administrata**

**DEKLARATA E MISIONIT:** : Të sigurojë barazinë e mundësisë për të ndjekur arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm të të gjithë qytetarëve të komunës, përfshirë edhe pakicat/minoritet, të mbështesë zhvillimin dhe aftësimin e personelit, të nxisë bashkëpunimin midis mësimitdhënësve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore. Të jap udhëzime personelit dhe të menaxhojë me asetet e drejtorisë në mënyrë sa më të mire, si dhe të sigurojë shërbimet e duhura për funksionimin sa më të mirë të arsimit në komunë.

**Sektori i administrates dhe kontrollit**

**DEKLARATA E MISIONIT:** Protokolimin e te gjitha akteve juridike dhe shkresaveqe parashtrohen ne DKA dhe shqyrtimin procedimin ,hartimin e akteve te ndryshme ,propozimeve ,aktvendimeve vendimeve , shqyrtim te ankesave ,hartim te kontratave dhe mbledhjen e shenimeve statistikore per nxenes puntor arsimor ne nivel komune.

Kontrolli-kontrollimin inspektimin dhe mbi kqyrjen ne zbatimin e ligjeve nga lemia e arsimit inspekon mbikqyrjen ne arsimin parafillor , fillor dhe te mesem.

**Sektori i buxhet dhe financa**

**DEKLARATA E MISIONIT:** Sektori i buxhetit dhe financave është përgjegjëse për planifikimin e buxhetit, për të gjitha shkollat e komunës, rishikimin e buxhetit, planifikimin e shpenzimeve sipas kategorive, lejimin e pagesave me para të gatshme, mban shënime për fondet e pranuar nga donatorët, kontrollon shpenzimet e shkollave


**Sektori planifikimit dhe zhvillimit**

**DEKLARATA E MISIONIT:** Mirret me planifikimin e proqesit edukativo arsimor, themelimin dhe funksionimin e sistemit shkollor: parafillor ,fillor dhe te mesem dhe me aftesi te kufizuar.

**Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025**

Paga dhe meditje	6,763,529,00 €
Mallra dhe Sherbime	493,000,00 €
Komunali	75,000.00 €
Kapitale	90.000.00 €
Gjithes.	7,421,529,00 €

**Programi : bujqësi pylltari dhe zhvillim rural**



**Drejtoria për bujqësi pylltari dhe hidroekonomi**

Deklarata e misionit: drejtoria për bujqësi pylltari dhe hidroekonomi bënë menaxhimin e stafit të drejtorisë, burimeve financiare dhe bënë koordinimin me agjencionet tjera qeveritare për aktivitetet bujqësore, ofrimi i informative për fermeret dhe bizneset bujqësore dhe përmirësimin e njohurive bujqësore teknike dhe praktike të menaxhimit të zonave rurale.

**Administrata**

Deklarata e misionit: Administrata është përgjegjëse për koordinimin e punëve me OJQ me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve bujqësore, të lidhë dhe bashkëpunojë me kooperativat bujqësore, ofrojë trajnime, ofrojë shërbime veterinerë dhe të kujdeset për mbrojtjen e shëndetit dhe parandalojë sëmundjet e kafshëve, koordinojë dhe të mbikëqyrë aktivitetet e tjera të parapara në programin e kësaj drejtorie.

**Sektori për planifikim dhe zhvillim bujqësi**

Deklarata e misionit; Implementon politikat zhvillimore për bujqësi, koordinon dhe mbikëqyrë kooperativat bujqësore, asociacionet bujqësore, përgatit planin vjetor për të mbjellat vjetore dhe siguron që këto plane të implementohen.

**Sektori për mbrojtje dhe kontroll**

Deklarata e misionit: mbrojtja e tokave nga ndryshimet pa kriter i destinimit, sigurimi i tokës nga ndotja, mundësia e mbrojtjes së pyjeve

**Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025**

Paga dhe meditje	48,260,00 €
Mallra dhe Shërbime	14,000,00 €
Subvencione	350,000,00 €
Gjithes,	412,260,00 €

**Programi : Planifikimi urban dhe mjedis**

**Drejtoria për planifikim urban**

**DEKLARATA E MISIONIT:** : Siguron zbatimin e ligjit dhe vendimeve tjera të aplikueshme nga fushëveprimi dhe kompetenca e drejtorisë, bënë përgatitjen dhe hartimin e akteve të përgjithshme normative të drejtorisë, bënë përgatitjen dhe hartimin e projektvendimeve, aktvendimeve, konkluzave, urdhëresave, procesverbaleve, kontratave, vërtetimeve, lajmërimeve dhe shkresave tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë e drejtorisë.

**DEKLARATA E MISIONIT:** Administrata është përgjegjëse për të mbajtur marrëdhënie të ngushta me qeverinë qendrore-Agjencionin Kadastral të Kosovës Ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit. Të menaxhojë çështjet buxhetore dhe financiare të drejtorisë dhe stafit, të nxjerr politika dhe rregulla për menaxhimin e drejtorisë

#### Sektori i urbanizimit

**DEKLARATA E MISIONIT:** : bënë dhenjen e informatave për përgatitjen e planeve urbane, lëshon lejet e ndërtimit, lejet për adoptimin e ndërtesave, rindërtimin e ndërtesave, lëshon lejet për infrastrukturë (sistemit të furnizimit me ujë, kanalizimit, rrugëve, etj).


#### Sektori i pronësisë

**DEKLARATA E MISIONIT:** Sektori i pronësisë bënë evidentimin e pronave komunale të uzurpuara nga ana e qytetareve, përgadit procedurat për ekzekutuara, perfaqson drejtorin lidhur me lëndë të uzurpuara në Gjykatën komunale. Udhëheq procedurën e eksproprijimeve.

#### Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025

Paga dhe medijtje	47,959,00 €
Mallra dhe Sherbime	110,000.00 €
Gjithes.	157,959,00 €

#### Programi : Shëndetsi dhe mirëqenje sociale



#### Deklarata e Misionit:

DSHMS ka për mision të vetin të sigurojë dhe të zhvillojë zbatimin e parimeve të kujdesit shëndetsor. Kujdesi shëndetsor zbatohet dhe udhëhiqet nga parimet vijuese :Barazia ,Cilesia,Ndershmeria dhe përgjegjesia,gjithpërfshirja dhe jo diskriminimi, financimi i qendrueshëm ,financimi kosto-efektiv .Misioni kryesor i DSHMS është trajtimi korrekt i qytetareve bazuar në ligj,dhe respektimi i plote i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut , të percaktuara me konventa ndërkombetare. Sigurimi i qasjes së plote të kujdesit shëndetsor në të gjitha nivelet që disponon potenciali i komunës dhe qytetareve , si dhe për personat me aftësi të kufizuara , në mënyrë që të kenë një qasje sa më të lehtë fizike të kujdesit shëndetsor.d.m.th sistemin e afërimit të mbrojtjes shëndetsore sa më kualitative , duke u bazuar në strategjinë e kujdesit primar shëndetsor dhe nevojat e popullatës në tërësi të territorit të Komunës së Vitisë,kujdesi i veçantë do të përkushtohet mbrojtjes antenatale shëndetit të nënës dhe fëmijës , pacientëve të sëmundjeve kronike si përkujdesjen për imunizim dhe shëndetin publik të popullatës.Qëllimi i drejtorisë së Vitisë është që të afrohet shërbime mjekësore të gjithë qytetarëve ,sidomos atyre qytetarëve që kanë nevojë për ndihmë mjekësore ,në çdo kohë dhe në çdo moment ku do të gjenden dhe kush do të ka nevojë për ndihmë në territorin e komunës së Vitisë.

#### Përmbledhja e burimeve të programit

## **Programi: Burimet e pozitive**

### **Administrata**

- Sektori i shëndetit publik
- Sektori i shëndetit primar
- Sektori i buxhetit dhe financave

### **Administrata**

**Deklarata e Misionit:** DSHMS do të kujdeset për shfrytëzimin efikas dhe racional të burimeve të mjetëve, mbikqyrja dhe kontaktimi i shërbimeve si model themelor i marrëdhënieve financiare. Financimi me mundësi kosto-efektive, mbështetje financiare me mundësi të modalitetit përmes buxhetit të Kosovës dhe buxhetit të komunes, si dhe pagesave të qytetareve. Përdorimi i ndërsheëm dhe përgjegjësi të mjetëve financiare publike, gjithë përfshirja dhe jo diskriminimi, kujdes shëndetësor për të gjithë qytetarët pa marrë parasysh nacionalitetin, fene, gjininë, racën, ngjyrën, bindjen politike, gjendjen sociale etj. Do të angazhohemi deri në atë shkallë që të bëjmë të mundur funksionimin e Drejtorisë, për krijimin e një disipline të lartë në të gjitha repartet, për të krijuar një rend dhe rregull për një zhvillim strategjik, për një përkujdesje për realizimin e projekteve prioritare në DSHMS me një fjalë organizimin e përgjithshëm të Drejtorisë së shëndetësisë në Komunën e Vitisë.

### **Sektori i Shëndetit publik**

#### **Deklarata e Misionit:**

Qëllimi kryesor i sektorit të shëndetësisë është që të kujdeset për shëndetin publik të qytetareve të komunes, interesimi i këtij sektori është që të kujdeset në përgjithësi për shëndetin publik. Me rëndësi të veçantë është që popullata e jonë të ndihet e sigurtë në çdo kohë dhe çdo moment me shërbime shëndetësore dhe sociale dhe të mos synojmë që shërbimet mjekësore të jenë sa më afër qytetarit dhe atë me një qasje 24 orëshe.

### **Sektori i shëndetit primar**

**Deklarata e Misionit:** Qëllimi kryesor i shëndetit primar është kujdesi parësor shëndetësor i qytetareve të Komunes së Vitisë. Në kuadër të shëndetit primar funksionojnë 6 QMF, 6 AMF si dhe QKMF-ja, ku përmes repartëve të saja të veçanta bëhet afrimi i shërbimeve emergjente, shërbimeve primare të mjekësisë familjare, shërbimeve të imunizimit, shërbimeve gjinekologjike dhe të planifikimit familjar, përkujdesja për të smuret kronik dhe të semuret me smundje malinje, si dhe transporti i rregullt i pacientëve në hemodialize. Objektivi i menagjimentit të kujdesit primar do të jetë edhe kujdesi palliativ-terminal duke bërë krejt atë që është e mundur që vuajtjet dhe fatkeqësit të përballohen bashkarisht me pacientin.

### **Sektori Buxhetit dhe financave**

**Deklarata e misionit:** Sektori i buxhetit dhe financave bën planifikimin e buxhetit për QKMF-në, për shëndetin publik, sektorin e shërbimeve sociale të Komunes, rishikon buxhetin në afatet e përcaktuara me ligj, planifikimin e shpenzimeve sipas kategorive, lejon pagesave me para të gatshme, shtyn proceset në realizimin e projekteve, mban shënime për fondet e financuara nga donatorët, kontrollon të gjitha shpenzimet në Drejtori dhe jep propozime me të mira për zbatimin e parimeve të Ekonomisë, në mënyrë që çdo gjë të përfundojë në formën më të mirë të mundshme, gjithmonë në pajtim me ligjet në fuqi sidomos të Ligjit mbi menagjimin e financave publike dhe përgjegjësit, dmth përkujdesje të vazhdueshme të zbatimit të gjitha ligjeve në fuqi të shpenzimeve të mjetëve financiare dhe të parave publike.

### **Shpërndarja e buxhetit për Vitin 2025**

Paga dhe meditje	1,385,661.00 €
Mallra dhe Shërbime	847,235.00 €
Shpenzime komunale	57.600.00 €
<u>Shpenzime kapitale</u>	<u>10.000.00 €</u>
<b>_Totale</b>	<b>2,300,495.00 €</b>

### **Programi : Sektori i Mirqenja Sociale:**


**Deklarata e Misionit:** Qëllimi kryesor i këtij sektori është që të grumbulloj kërkesat e qytetareve dhe në bazë të këtyre kërkesave të qytetareve me gjendje të rënde sociale, dhe në bazë të kritereve të një komisioni Regjional i mjekëve formohen listat për dhënjën e ndihmave sociale të njerëzve me gjendje të rënde sociale. Objektivi i yne është që të ju ndihmohet atyre që kemi mundësi financiare me shërbime sociale, asistencë sociale dhe duke përfshirë edhe strehimin e atyre që mund të jenë të rrezikuar. E gjithë kjo bëhet me anë të identifikimit dhe vlersimit të gjendjes sociale të familjeve të propozuara dhe që kanë kërkuar ndihmë sociale.

## Shperndarja e buxhetit per Vitin 2025

Paga dhe meditje	120,000.00 €
Mallra dhe Sherbime	65,000.00 €
Subvencione e transfere	50,000.00 €
Shpenzime kapitale	50,000.00 €

**Totale** 290,000.00 €

Programi : Kultur , rini e sport



### Administrata

Deklarata e misionit: Planifikon, menaxhon dhe koordinon punën e sektorëve të DKRS. Menaxhon stafin, objektet dhe buxhetin e DKRS.

Planifikon, harton dhe mbikqyrë realizimin e palnprogramit vjetor të punës. Raporton para Kuvendit, Kryetarit, Kryeshefit...

### Zyra për kulturë

Deklarata e misionit: Organizon dhe koordinon veprimtaritë kulturore: Teatër, manifestime, art figurativ, muzikë...etj për të gjitha moshat. Siguron mbështetjen teknike për manifestimet dhe programet tjera në sallën e kulturës dhe jashtë saj.

### Zyra për sport

Deklarata e misionit: Organizon garat sportive. Mbikqyrë garat sportive. Koordinon dhe mbështet veprimtaritë e klubeve sportive. Koordinon bashkëpunimin me qendrat sportive.

### Zyra për rini

Deklarata e misionit: Organizon dhe përkrah aktivitetet rinore me rëndësi shoqërore dhe kulturo-sportive. Koordinon punën me OJQ dhe shoqata rinore. Planifikon dhe raporton për punën vjetore..


### Sektori i arkivit

**DEKLARATA E MISIONIT:** Mirret me klasifikimin e lendeve arkivore, sistemimin dhe ruajtjen e lendeve arkivore.

*Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025*

Paga dhe meditje	84,350.00 €
Mallra dhe Sherbime	60,000.00 €
Subvencione	150,000.00 €
Gjithes.	294,350.00 €

Programi : Shërbime publike dhe gadishmëri emergjente



**Drejtoria e Sherbimeve Publike**

DEKLARATA E MISIONIT: Siguron zbatimin e ligjit dhe vendimeve tjera të aplikueshme nga fushëveprimi dhe kompetenca e drejtorisë, bënë përgatitjen dhe hartimin e akteve të përgjithshme normative të drejtorisë, bënë përgatitjen dhe hartimin e projekt vendimeve, aktvendimeve, konkluzave, urdhëresave, procesverbaleve, kontratave, vërtetimeve, lajmërimeve dhe shkresave tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë e drejtorisë.

**Administrata**

DEKLARATA E MISIONIT: bënë planifikimin dhe zhvillimin e planeve te ndryshme qe kane te bejne me drejtorin ,bene kryerjen e puneve ne harmoni me pershkrimet e detyrave te punes.

**Spektori i trafikut dhe transportit**

DEKLARATA E MISIONIT: bënë mirëmbajtjen e komunikacionit , shenjezimin e rrugeve, inspektimin e komunikacionit rrugëve të komunës, . Lëshon lejet për punë të kompanive transportuese(mallrave dhe udhetareve, brenda komunës dhe kujdeset që këto kompani të jenë të pajisura me mjetet e nevojshme.

**Spektori i sherbimeve komunale dhe mbrojtje te ambientit**

EKLARATA E MISIONIT: Bene plane , rregullore propozime ne lidhje ambient dhe sherbime komunale si rruge, kanalizim ,ujesjelles pastaje mirembajtjen e hapësirave publike , monitoron punen e kompanive ne mirembajtjen është përgjegjëse për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe parqeve.

*Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025*

Paga dhe meditje	283,641.00 €
Mallra dhe Sherbime Komunali	1,1175,684.00 €
Komunali	162,400,00 €
Gjithes.	1,621,7250.00 €

Programi : Zyra komunle dhe komunitete

*Shperndarja e Buxhetit per Vitin 2025*

Paga dhe meditje	23,961.00 €
<u>Mallra dhe Sherbime</u>	<u>1,000.00 €</u>
Gjithes.	24,961.00 €



*Blumaj*



## PLAN BUXHETI 2025-2027

Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm i politikës ekonomike që ka në dispozicion qeveria komunale, dhe si i tillë ai pasqyron prioritetet e saja zhvillimore. Derisa buxheti rregullon të hyrat dhe shpenzimet për një vit fiskal të caktuar, procesi buxhetor është i vazhdueshëm dhe përsëritet çdo vit. Komuna në muajin qershor ka hartuar Kornizën Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve (KAB-i), një dokument planifikues afatmesëm që synon të përmirësojë parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e buxhetit, duke përfshirë buxhetin e vitit të ardhshëm fiskal dhe parashikimet buxhetore edhe për dy vitet fiskale të tjera, kur hartohet buxheti vjetor, Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve ka nxjerr qarkoret buxhetore 1 dhe 2 etj, që japin kufijt fillestar, informata dhe udhëzime rreth strukture së shpenzimeve në fonde burimore dhe kategori ekonomike dhe kufijt final për vitin e ardhshëm fiskal dhe parashikimet për dy vitet pasuese, përcaktojnë procesin e bashkërendimit midis organizatave buxhetore dhe Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve.

Përgatitja e buxhetit 2025-2027 ka filluar nga muaji maj i vitit 2024, konform LMFPP dhe Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal. Këtë periudhë kohore e kanë përcjell dy qarkore buxhetore të lëshuara nga MFPT-ja, qarkorja e parë buxhetore 2025/01, të datës 15.05.2024 jemi njoftuar për kufijt fillestar të shpenzimeve të granteve buxhetore për vitin 2025 si dhe parashikimet për vitin 2026 dhe 2027.

Kufijt nëpër kategori ekonomike janë të përcaktuar me qarkoren buxhetore 2025/02 kështu:

Plan buxheti i vitit 2025 është përgatitur në bazë të Statutit të Komunës së Vitisë, duke bërë shpërndarjen e fondeve nëpër drejtori / programe dhe nënprograme.

**Në qarkoren e parë buxhetore 2025/01 paraqiten udhëzimet e para: kalendari kohor, kufijt fillestar të përgatitjes së KAB-it Komunal dhe fillimit të përgatitjes së Plan Buxhetit Komunal për vitet 2025-2027 që paraqitet kështu :**

<i>Grantet</i>	<i>2024</i>	<i>2025</i>	<i>2026</i>	<i>2027</i>
Granti i përgjithshëm	7,133,658	7,705,066	8,151,538	8,606,154
Granti specifik i Arsimit	6,601,224	6,887,645	7,094,275	7,307,103
Granti specifik i Shëndetësis	1,733,807	1,927,784	2,019,547	2,115,677
Granti për shërbimet rezidenciale	160,000	155,000	200,000	200,000
THV	1,029,502	1,270,127	1,368,216	1,468,034
<b>Totali</b>	<b>16,658,191</b>	<b>17,945,622</b>	<b>18,833,576</b>	<b>19,696,968</b>

Në qarkoren e dytë buxhetore 2025/02 janë dhënë kufijt e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike (duke përfshirë shpenzimet e pagave dhe shtesave, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale) për vitet 2025-2027.

Buxheti komunal për vitin fiskal 2025-2027 do të paraqitet sipas 5 kategorive ekonomike për shpenzimet e buxhetuara në pajtim me rregullat e thesarit:

KUFIJT BUXHETOR SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE PËR VITET 2024-2027					
nr.	Kategorit ekonomike	2024	2025	2026	2027
1	Paga e mëditje	9,592,934	9,887,124	10,430,916	10,983,754
2	Mallra e shërbime	2,632,918	3,172,919	3,236,377	3,301,105
3	Shpenzime komunale	295,000	300,000	313,500	329,175
4	Subven. e transfere	570,000	720,000	756,000	816,480
5	Shpenzime kapitale	3,562,339	3,865,579	4,096,783	4,266,454
	<b>Totali</b>	<b>16,653,191</b>	<b>17,945,622</b>	<b>18,833,576</b>	<b>19,696,968</b>

Ndryshimi i kufijëve buxhetor për vitin 2025 në krahasim me vitin 2024

✓	Granti i Përgjithshëm ..... ( rritje	571,408 )	.....	7,705,066
✓	Granti i Arsimit ..... (rritje	286,421 )	.....	6.887,645
✓	Granti i shëndetësisë ..... (rritje	193,977 )	.....	1.927,784
✓	Granti per sherbime rezidenciale( i njëjt)	---	-----	155,000
✓	Të hyrat vetanake .....(rritje	240,625 )	.....	1,270,127
	<b>Gjithësejt..... ( rritje</b>	<b>1,292,431)</b>	<b>.....</b>	<b>17.945,622</b>

Dallimi i buxhetit në mes të viteve 2024 dhe 2025


Kategorit ekonomike	2024	2025	diferenca
Paga e mëditje	9,592,934	9,887,124	294,190
Mallra e shërbime	2,632,918	3,172,919	540,001
Shpenzime komunale	295,000	300,000	5,000
Subven. e transfere	570,000	720,000	150,000
Shpenzime kapitale	3,562,339	3,865,579	303,240
<b>Totali</b>	<b>16,653,191</b>	<b>17,945,622</b>	<b>1,292,431</b>

Buxheti i Komunës së Vitisë përbëhet nga dy burime kryesore.

1. **Grantet qeveritare** (granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit dhe granti specifik i shëndetësis dhe granti për shërbime rezidenciale).
2. **Të hyrat vetanake komunale.**

### Buxheti i Komunës në vitet 2023 – 2027

Buxheti sipas viteve	
Viti 2023	14,996,356.00
Viti 2024	16,653,191.00
Viti 2025	17,945,622.00
Viti 2026	18,833,576.00
Viti 2027	19,696,968.00



Buxheti i Komunës së Vitisë si tërësi ka shënuar rritje në vitin 2025 në krahasim nga viti 2024 në vlerë prej 1,292,431 € ose prej 7.76 %. Në vitin 2024 shuma e buxhetit ishte në vlerë prej

16,653,191 €, në vitin 2025 shuma e buxhetit është në vlerë prej 17,945,622 €, në vitin 2026 është në vlerë prej 18,833,576 € në vitin 2027 është në vlerë prej 19,696,968€.

Rritje është reflektuar në grantin e përgjithshëm në vlerë prej 571,047 €, rritje në grantin specifik të arsimit në vlerë prej 286,421 €, rritje në grantin specifik të shëndetësisë 193,977 €, kurse total grantet kanë rritje prej 1,051,805 €.

Të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2024 në shumë prej 240,625 € ( 1,029,502 € në vitin 2024 dhe 1,270,127 € në vitin 2025) .

Në materialin e paraqitur kemi planifikimin e buxhetit për të gjitha linjat buxhetore, si: administrata komunale, arsimit dhe shkenca, shëndetësia dhe mirëqenja sociale dhe shërbimet sociale. Këtu janë përdorur të gjitha kriteret të cilat janë të parapara me LMFP, për ndarjen e buxhetit, kriteri funksional, organizativ, ekonomik e burimor, duke e respektuar edhe kodin e nënzërave pesë shifror në sistemin e BDMS-së.

Ndarja e mjeteve të **grantit të përgjithshëm** duke kalkuluar në nr e popullsis sipas regjistrimit të popullsis të vitit 2011 komua jonë ka numër të banorëve prej 46,987 banor ,bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (I) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (II) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (III) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (IV) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%). (Shif QB 2024/01 faqe 13)

Në kuadër të programit të arsimit kemi ndarjen sipas katër nënprogrameve në:

1. Administratë ( financohet nga granti i përgjithshëm),
2. Arsimit parashkollor / çerdhet -financohet nga granti specifik i arsimit, ndihmohet nga granti i përgjithshëm dhe nga të hyrat vetanake,
3. Arsimit fillor - financohet nga granti specifik i arsimit, ndihmohet nga granti i përgjithshëm dhe nga të hyrat vetanake,
4. Arsimit i mesëm - financohet nga granti specifik i arsimit, ndihmohet nga granti i përgjithshëm dhe nga të hyrat vetanake.

**Në programin e arsimit** - Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2024-2026. Grantin specifik për arsim para universitar për vitin 2024 është aprovuar nga Komisioni i Granteve .

Politikat në vazhdimësi të aprovuara nga komisioni i granteve si në vijim:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2023/2024;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës I staf në arsimin parafillor dhe fillor;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës I staf në arsimin e mesëm

- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
- k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
- l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
- m) Koordinatorët e cilësisë;
- 7
- n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- o) Kapitallet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
- p) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta;
- q) Praktika profesionale;
- r) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla);
- s) Këshilltarë të karrierës me bazë në shkollë klasa 6 deri 9;
- t) Specialist të IT-së.

Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 4,180 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak në nivel vendi.

Me Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/02 do të bëhet rishikimi dhe harmonizimi i stafit në sektorin e arsimit para-universitar.

Sipas MASHTI-të është raportuar se nr i nxënësve në vitin 2025 do të jetë 7,026 nxënës, numri për 316 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak (7,342 nxënës) . Numri i pozitive të shtuara është për 12 për funksionalizimin e qerdhës së fëmijëve në fshatin Drobesh.

Në kuadër të programit të **shëndetësis dhe mirëqenjes sociale** gjithashtu kemi ndarjen sipas dy nënprogrameve atë në:

1. Administratë ( financohet nga granti i përgjithshëm),
2. Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor.

Në kuadër të programit të shërbimeve sociale është projekti i shërbimeve sociale dhe rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara që kryesisht financohet nga granti i përgjithshëm. Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2024 (SHKPAK) në shumë prej 155.000 €,

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2025 është aprovuar sipas kriterit për kokë banori dhe kosto shtesë për paga dhe mëditje. Shpërndarja e grantit specifik për Shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL. Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2025 është përgatitur sipas kriterit për kokë banori dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Granteve të dala nga raporti vjetor mbi Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit Komunal..

- Politikat në vazhdimësi me kosto të cilat janë:
  - Vizitat në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë (vizita x 10 euro).
  - Vizitat e kujdesit paliativ (vizite x 20 euro) .

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale (politikës së të ardhurave si nga granti i qeverisë dhe të hyrave vetanake komunale si dhe shpenzimeve buxhetore.

Gjatë hartimit të projekt buxhetit sa më saktë ti paraqesim shpenzimet për të gjitha programet dhe nënprogramet buxhetore - është bërë përgatitja e planit dinamik të shpenzimeve në sistemin e kodeve pesë shifrore dhe dinamikës së të hyrave.

Në bazë të projekt buxhetit do të përgatitet plani i rrjedhës së paras çka rezulton alokimi i mjeteve financiare për ekzekutimin e buxhetit të organizatës buxhetore, apo më mirë të themi plani rrjedhës së parasë së gatshme. Kjo është domosdoshmëri, sepse në bazë të kësaj do të bëhet edhe alokimi i mjeteve nga MFPT-ja, gjithashtu në bazë të kësaj dinamike të shpenzimeve do të përgatitet edhe plani i prokurimit për të gjitha njësit buxhetore komunale.

Për vitin 2026 dhe viti 2027 kemi vetëm vlerësimet e hershme, kemi përgatitjen e formës standarde për të gjitha programet buxhetore dhe atë sipas kategorive ekonomike.

Si objektivi i qeveris komunale në bazë të plan buxhetit të vitit 2025-2027 është:

- Përpilimi i një buxheti të qëndrueshëm për Komunën e Vitis,
- Synimi i një planifikimi sa më real i shpenzimeve dhe i të hyrave buxhetore ,
- Transparenca gjatë hartimit të buxhetit ,
- Zgjedhja e prioriteteve të projekteve kapitale për vitin buxhetor 2025 si dhe vlerësimet e hershme për dy vitet e ardhshme 2026 dhe 2027 .

#### **Buxheti për vitin 2025 – kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave**

Kemi rritje të kategoris ekonomike të pagave dhe shtesave (mëditjeve) në vlerë prej 294,190 €.

Kategorinë ekonomike të pagave e mëditjeve e ndarë në katër linja buxhetore :

Programet	Shuma në €	%
Administrata	1,617,934.00	16.36
Arsim e shkencë	6,763,529.00	68.41
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	1,385,661.00	14.01
Shërbimet sociale-rezidenciale	120,000.00	1.21
